



REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR SHKODËR

Nr.Regj.Them 152/890 (1452)  
Dt.Regj. 31.07.2017

Nr.Vendimi 485 (1342)  
Dt.Vendimi 26.03.2018

V E N D I M

"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër e përbërë prej:

**GJYQTARE:** Luveda Dardha

Asistuar nga sekretare gjyqësore Mirela Vuksani, sot më datë 26.03.2018, me kërkesën e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, përfaqësuar nga prokurore **Françeskina Lekani**, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike çështjen penale që i përket:

TË PANDEHURIT:

**Arvit Bushati**, i biri i Ridvan dhe i Sevdie, i datëlindjes 03.09.1990, lindur në Brazhd – Shosh dhe banues në Shkodër, lagja "Perash", me gjëndje civile "beqar", me arsim të lartë me gjëndje gjyqësore "i padënuar", hetuar dhe gjykuar në gjëndje të lire, mbrojtur në gjykim nga Av.Bujar Hoti dhe Av.Mirsad Isufi, anëtarë të Dhomës së Avokatisë Shkodër, zgjedhur nga i pandehuri, në mungesë në shpalljen e vendimit

AKUZUAR:

Për kryerjen e veprës penale të "*Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime dhe manifestime të paligjshme*", të parashikuar nga neni 262/1 i Kodit Penal,

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, pasi administroi provat e ndodhura në fashikullin e procedimit penal dhe pasi dëgjoi;

*Prokuroren, e cila kërkoi: "Deklarimin fajtor të të pandehurit Arvit Bushati për kryerjen e veprës penale " Organizim dhe pjesëmarrje në grumbullime dhe manifestime të paligjshme", e parashikuar nga neni 262/1 i K.Penal dhe dënimin e tij me 2 (dy) muaj burgim. Sugjerojmë gjykatën që të aplikojë kërkesat e nenit 406 të K.Pr.Penale, duke ulur dënimin me 1/3. Në aplikim të nenit 63 të K.Penal pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim me detyrimin që i pandehuri të kryejë punë në interes publik pa shpërblim. Shpenzimet procedurale të kryera gjatë hetimeve paraprake në shumën 2000 (dymijë ) lekë t'i ngarkohen të pandehurit Arvit Bushati".*

Mbrojtësi i të pandehurit Arvit Bushati, Av.Mirsad Isufi , i cili kërkoi: " Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit Arvit Bushati, pasi fakti penal nuk ekziston dhe nuk kemi të bëjmë me grumbullim të paligjshëm;

I pandehuri Arvit Bushati, i cili kërkoi: " Pafajësi", si dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi;

## VËREN:

### 1. Rrethanat e Faktit

1. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me kërkesën me objekt gjykimin e procedimit penal nr.445, i vitit 2017 në ngarkim të të pandehurit Arvit Bushati, i cili akuzohet për kryerjen e veprës penale "Organizim dhe pjesëmarrje në grumbullime dhe manifestime të paligjshme", e parashikuar nga neni 262/1 i K.Penal.

2. Nga aktet shkresore të ndodhura në dosje, të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor rezultoi se në datën 01.03.2017, në lagjen " Qemal Stafa", të qytetit të Shkodrës gjatë vizitës së Kryeministrit, është organizuar një protest, nga një grup personash, e drejtuar nga shtetasi Arvit Bushati. Nga ana e organit procedues nëpërmjet procesverbalit " Për kryerjen e pamjeve filmike", datë 01.03.2017 janë marrë pamjet filmike të regjistruara në You Tube, nën titullim " Rama pritët me protesta në Shkodër". Në këtë procesverbal është pasqyruar se: " Pas klikimit të çeljes së kësaj video konstatohen pamje filmike, një grupim personash me pankarta në duar, duke qëndruar në këmbë, të cilët brohorisin kundër qeverisë, me mbishkrime kundër qeverisë dhe Kryeministrit. Në vijim nga kqyrja e këtyre pamjeve filmike konstatohen shtetasi Arvit Bushati, duke folur përpara mikrofonit të gazetarëve të televizioneve lokale kundër qeverisë dhe Kryeministrit. Nga kqyrja vërehet se kohëzgjatja e filmimit është 1 (një) minutë e 50 (pesëdhjetë) sekonda".

3. Në vijim të veprimeve hetimore është pyetur në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, shtetasi Arvit Bushati, ku ka deklaruar se: " .....gjatë kohës ku neve po qëndronim në kafe nëpërmjet mediave morëm dijeni për vizitën e Kryeministrit që do të bënte në Shkodër. Sapo përfunduam kafën rreth 50 persona anëtar të forumit rinor Shkodër nga karioziteti dolëm për të parë nëse ishin mbledhur njerëz gjatë vizitës së Kryeministrit. Në këtë moment neve u vendosëm të sheshi 2 Prilli brenda territorit të kafe Venecia dhe ashtu në qetësi qëndruam. Pak caste më mbrapa Kryeministri doli nga ambientet e Hotel Europës dhe për të na provokuar çoi dy gishtat lart dhe me zë të ulët na ofendoi. Në atë moment reagimi jonë ishte paqësor, pa përjashtuar edhe ndonjë reagim emocional të ndonjërit prej djemve, i ardhur edhe si pasojë e sjelljes së policisë ndaj nesh. Kam për të deklaruar se nuk ka qenë as organizim, as paramendim, por siç deklarova më lart në kafe morëm dijeni për vizitën e Kryeministrit dhe nga kuroziteti për të parë nëse vizita do të ishte e suksesshme dhe do të kishte pjesëmarrje u vendosëm të kafe Venecia.....dua të theksoj se nuk kemi shkuar në sheshin 2 prilli me

qëllimin për të protestuar, gje) rastin të theksoj se u vendosëm aty tjetërt nga kurioziteti për të parë pjesëmarrjen e takimit që kishte organizuar Z.Rama, por reagimet emocionale kanë filluar pas provokimit që na u bë nga Kryeministri..... Dua të deklaroj se në bazë të filmimeve nuk arrij të konstatoj kush ish-in personat që ishin me pankarta, ndërsa pjesën tjetër afër meje ishte Ergys Ivziku, Aleksander Alija e Elsad Amuli, të gjithë këto persona janë anëtarë kryesisht dhe K/grup seksionesh pranë degës së Forumit Rinor Shkodër”.

4. Nga shkresa me Nr.2219/1 prot, datë 20.04.2017 nga Komisioni i Policisë Shkodër, rezultojnë se nuk është kërkuar leje as nga shtetasi Arvit Bushati dhe as nga ndonjë person apo grup personash të tjerë për të zhvilluar protestën në fjalë. Me vendimin “ Për marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës”, datë 13.07.2017, organi procedues i ka njoftuar shtetasit Arvit Bushati akuzën për veprën penale sipas neni 262/1 të K.Penal, duke marrë edhe cilësinë e të pandehurit. I pyetur në cilësinë e të pandehurit, shtetasi Arvit Bushati ka deklaruar se nuk e pranon akuzën, duke ju qëndruar deklaratimeve të dhëna më parë.

5. Në këto kushte bazuar në provat sa më sipër Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër i është drejtuar Gjykatës me kërkesë, ku kërkon gjykimin e procedimit penal në ngarkim të të pandehurit Arvit Bushati për kryerjen e veprës penale “Organizim dhe pjesëmarrje në grumbullime dhe manifestime të paligjshme”, e parashikuar nga neni 262/1 i Kodit Penal.

## II. Vlerësimi i Gjykatës

6. Në seancën gjyqësore të datës 10.10.2017, i pandehuri Arvit Bushati, nëpërmjet mbrojtësit të tij, kërkoj në kërkesat paraprake që të procedohet me gjykim të shkurtuar. Gjykata, pas shqyrtimit me imtësi të të gjitha akteve të ndodhura në fashikullin e gjyqësorit, ku konstatoj se ato nuk përmbanin ndonjë pavlefshmëri nga ato të parashikuara në nenin 128 të K.Pr.Penale, vlerësoi se bazuar në nenin 405 të Kodit të Procedurës Penale, ka vend për të proceduar me gjykim të shkurtuar, pasi çmtoi se çështja mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet, pa cenuar drejtësinë dhe interesat e ligjshëm të të pandehurit dhe në kushtet kur kërkesa u paraqit në fazën e duhur procedurale, konkretisht përpara fillimit të shqyrtimit gjyqësor (neni 403).

7. Gjithashtu, duke pasur parasysh se gjyqësori i shkurtuar, si gjyqësori i posaçëm, eviton fazën e hetimit gjyqësor dhe në thelb të tij ka pranimin e akteve të grumbulluara gjatë fazës së hetimit paraprak, duke evituar marrjen e provave në seancë gjyqësore dhe debatin lidhur me to, me pranimin e kërkesës për të vazhduar me gjykim të shkurtuar, dosja e prokurorit u kthye në dosje gjyqësore dhe shërbeu për t'u bazuar në parashkrimin e konkluzioneve përfundimtare të palëve dhe për dhënien e vendimit nga gjykata. Gjyqësori penal u zhvillua vetëm mbi bazën e provave të siguruar gjatë fazës së hetimit paraprak, të cilat nuk iu nënshtruan debatit gjyqësor, nuk u administruan gjatë gjyqësorit prova të reja, analiza e elementëve të figurës së veprës penale u bazua vetëm mbi provat e paraqitura nga organi i akuzës, duke respektuar në këtë mënyrë kërkesat procedurale të gjyqësorit të shkurtuar të sanksionuara në Kodin e Procedurës Penale dhe të interpretuara për efekt të unifikimit të praktikës gjyqësore në Vendimin Nr. 2, datë 29.01.2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

8. Gjykata, paraprakisht evidenton faktin se për të pasur një figurë konkrete të veprës penale është e domosdoshme ekzistenca e të gjithë elementëve përbërës të saj të marra së bashku, të cilët janë: a) objekti i veprës penale; b) ana objektive; c) subjekti dhe ç) ana subjektive. Provueshmëria e elementëve objektive dhe subjektive të figurës së veprës penale, shërben si bazë për të vënë një person përpara përgjegjësisë penale. Gjithashtu, vepra penale paraqet në vetvete një unitet të të gjithë elementëve të figurës së saj. Ajo konsiderohet e kryer në mënyrë të plotë atëherë kur ekzistojnë të katër elementët e saj: objekti, ana objektive, subjekti dhe ana subjektive. Nëse mungon njëri prej këtyre elementëve, vepra penale nuk ekziston. Prandaj, në çështjen konkrete, gjykata, duhet të shohë e të verifikojë, ekzistencën e të gjithë elementëve të veprës penale dhe të figurës së saj në veçanti.

9. Duke u rikthyer në çështjen objekt gjykimi, prokuroria e akuzon të pandehurin Arvit Bushati për veprën penale *"Organizim dhe pjesëmarrje në grumbullime dhe manifestime të paligjshme"*, pasi nga rrethanat e faktit rezulton se ai i ka konsumuar të gjithë elementët objektiv e subjektiv të marrë së bashku, që kjo veprë penale të konsiderohet e kryer. Prandaj, në çështjen objekt gjykimi, gjykata, duhet të analizojë elementët e figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 262/1 i Kodit Penal. Në këtë nen parashikohet shprehimisht se: *"Organizimi i grumbullimeve dhe i manifestimeve të personave në sheshe dhe vende të kalimit publik, pa marrë më parë leje nga organi kompetent, sipas dispozitave të veçanta, apo kur nga organizatorët shkelen kushtet e parashtruara në kërkesën për dhënien e lejes, përbën kundravajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit."*

10. Në lidhje me objektin e veprës penale të parashikuar nga neni 262 i K.Penal, gjykata vëren se është vendosur në Seksionin III me titull "Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike", ku objekt i përgjithshëm i saj janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të mbrojtur rendin dhe sigurinë publike, nga kryerja e veprimeve apo mosveprimeve në kundërshtim me ligjin. Nga ana objektive vepra penale sipas paragrafit të 1-rë të nenit 262 të K.Penal, kryhet nëpërmjet veprimeve aktive, të cilat qëndrojnë në marrjen e masave organizative, lidhur me organizimin dhe manifestimet të personave në sheshe dhe vende të kalimit publik, me kushtin që të mos jetë marrë më parë leje nga organi kompetent. E drejta për t'u organizuar dhe manifestuar për qëllime të ligjshme, është një e drejtë kushtetuese e çdo qytetari, por kusht kryesor është që çdo organizim apo manifestim të realizohet duke marrë leje më parë te organi kompetent dhe duke ju qëndruar kushteve të parashtruara në kërkesën për dhënien e lejes. Nëse organizohen manifestime apo merret pjesë në to, pa u marrë më parë leje në organin kompetent apo duke shkelur kushtet e miratuara, veprimet në rastin konkret do të përbënin veprë penale sipas nenit 262 të Kodit Penal.

11. Neni 262 i K.Penal është një dispozitë, e cila të referon në ligjin e posaçëm Nr.8773, datë 23.04.2001 "Për tubimet", ku në nenin 2 të tij, pika 5 parashikohet se: *"Tubime" kuptohen grumbullimet, manifestimet, mbledhjet dhe parakalimet me karakter paqësor dhe pa armë, në të cilat një grup personash shprehim kërkesat dhe pikëpamjet e tyre për probleme për të cilat janë të interesuar dhe përfshin edhe tubimet urgjente. Kur grupe njerëzish*

grumbullohen në mënyrë spontane dhe nuk çenojnë rendin publik, veprimtaria e tyre nuk përshihet në përkufizimin e tubimit. 3. Sheshe dhe vendkalime publike kuptohen sheshet, bulevardet, rrugët dhe çdo mjedis tjetër që shfrytëzohet lirisht për lëvizjen dhe qëndrimin e çdo individit". Më tej në nenin 5 të këtij ligji, pika 1 e tij përcaktohet se: " Në rast tubimi në sheshe ose vendkalime publike, organizatori dhe drejtuesi janë të detyruar të njoftojnë me shkrim shefin e Komisarariatit të Policisë, jo më vonë se tri ditë para datës së zhvillimit të tubimit".

12. Duke i'u rikthyer çështjes objekt gjykimi rezultoi se organizimi i grumbullimit të disa personave, e drejtuar nga i pandehuri Arvit Bushati, cilësohet si një organizim i paligjshëm, në kuptim të nenit 262/1 të K.Penal, pa u marrë më parë leje pranë Komisarariatit të Policisë Shkodër. Nga kqyrja e pamjeve filmike rezultoi që ky organizim të mos jetë spontan, rastësor, por i parapërgatitur, pasi të gjithë pjesëmarrësit janë me pankarta në duar, duke brohoritur, në një vendkalim publik, me shprehje kundër qeverisë dhe vizitës së Kryeministrit, duke çenuar rendin dhe sigurinë publike. Nga ana tjetër edhe i pandehuri Arvit Bushati, sipas pamjeve filmike rezultoi të jetë në krye të këtij grupi personash, i cili jep një deklaratë për mediat, duke shprehur pakënaqësi ndaj qeverisë dhe Kryeministrit. Në këtë procesverbal është pasqyruar se: " Pas klikimit të çeljes së kësaj video konstatohen pamje filmike, një grupim personash me pankarta në duar, duke qëndruar në këmbë, të cilët brohorisin kundër qeverisë, me mbishkrime kundër qeverisë dhe Kryeministrit. Në vijim nga kqyrja e këtyre pamjeve filmike konstatohen shtetasi Arvit Bushati, duke folur përpara mikrofonit të gazetarëve të televizioneve lokale kundër qeverisë dhe Kryeministrit. Nga kqyrja vërehet se kohëzgjatja e filmimit është 1 (një) minutë e 50 (pesëdhjetë) sekonda".

13. Nga ana e mbrojtësit të të pandehurit në diskutimin e tij përfundimtar u pretendua se duke u nisur nga numri i vogël i personave, dhe qëndrimi i tyre përkohësisht në një vend të caktuar, nuk mund të quhet një grumbullim në kuptim të nenit 262 të Kodit Penal. Gjykata vlerëson se sipas ligjit të posaçëm nuk përcaktohet ndonjë numër minimum personash, të cilat kërkohen për të patur një grumbullim apo manifestim. Mjafton që të ekzistojnë më shumë se dy persona, të cilët paraqesin një organizim dhe qëndrueshmëri në sjelljen e tyre, duke u vendosur në vende apo sheshe publike, duke penguar aksesin e lëvizjes së lirë të qytetarëve në këto vende, si dhe duke kryer veprime apo shprehur mendime, të cilat çenojnë rendin dhe sigurinë publike. Në rastin konkret, nga pamjet filmike rezultoi se numri i personave të cilët kishin marrë pjesë, konsiderohen të mjaftueshëm për ta cilësuar si grumbullim apo manifestim të qëndrueshëm, në kuptim të ligjit të posaçëm, ku referon edhe neni 262/1 i K.Penal.

14. Nga ana subjektive, vepra penale kryhet me dashje të drejtpërdrejtë dhe i pandehuri plotëson kushtet për t'u marrë në përgjegjësi penale, pasi ka patur moshën e kërkuar nga ligji dhe ka qenë i përgjegjshëm në kohën e kryerjes së veprës penale. Për të gjitha arsytet e parashtruara sa më sipër, gjykata vlerëson se i pandehuri Arvit Bushati, duhet të deklarohet fajtor për kryerjen e veprës penale "Organizim dhe pjesëmarrje në grumbullime dhe manifestime të paligjshme", e parashikuar nga neni 262/1 i K.Penal.

- Lidhur me llojin dhe masën e dënimit

15. Neni 47 i K.Penal me titull "Mënyra e caktimit të dënimit" parashikon se: "Gjykata cakton dënimin duke respektuar dispozitat e pjesës së përgjithshme të këtij kodit dhe kufijtë e dënimeve të parashikuara në ligj për veprën penale. Në caktimin e dënimit ndaj personit ajo merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese". Gjykata vlerëson se në caktimin e llojit dhe masës së dënimit ndaj të pandehurit duhen marrë në konsideratë parashikimet ligjore si në sipër, në mënyrë që qëllimi i dënimit të jetë efektiv. Përveç karakterit ndëshkues të dënimit, thelbësor është rehabilitimi i të pandehurit, duke shmangur përfshirjen e tij në kryerjen e veprave të tjera penale në të ardhmen, qoftë vepra të të njëjtit lloj ose të ndryshme, si dhe ndërgjegjësimi me ndjenjën e edukimit dhe përgjegjësisë ndaj ligjit. Në caktimin e llojit dhe masës së dënimit gjykata çmon se duhet marrë gjithashtu në konsideratë edhe parimi i individualizimit të dënimit, pra që dënimi i caktuar të jetë në përputhje me rrethanat e rastit konkret dhe personalitetin e të pandehurit konkret.

16. Kriteret ligjore që duhet të marrë në konsideratë gjykata në caktimin e llojit dhe masës së dënimit janë si vijon: a) rrezikshmëria shoqërore e veprës penale; b) rrezikshmëria e autorit të saj; c) shkalla e fajit; d) rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Përcaktimi i rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale lidhet gjithmonë me natyrën dhe llojin e saj, me masat e dënimit që përcakton neni përkatës, me përhapjen, pasojat që ka sjellë. Këtu, Gjykata thekson se vepra penale "Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime dhe manifestime të paligjshme" përbën kundravajtje penale, për të cilën ligjvënësi parashikon dënimin me gjobë ose burgim në maksimum deri në një vit. Pra nisur nga marzhet e dënimit, kjo vepër penale nuk paraqet rrezikshmëri të lartë shoqërore, në kushtet kur dënimet që parashikohen janë me gjobë ose burgim në maksimum deri në një vit.

17. Lidhur me rrezikshmërinë e autorit të veprës penale, gjykata çmon se merren në analizë përveç rrezikshmërisë së veprës së kryer edhe motivet, qëllimet si dhe veçoritë e personalitetit të të pandehurit. Vepra penale për të cilën akuzohet i pandehuri nuk kërkon ndonjë qëllim, motiv apo pasojë të caktuar, pra konsiderohet e kryer, mjafton të rezultojë organizimi apo marrja pjesë në një grumbullim të paligjshëm, pra është një vepër penale formale. Rezultoi e provuar se i pandehuri nuk paraqet rrezikshmëri shoqërore, madje ai është e padënuar më parë, dhe me arsim të lartë.

18. Në lidhje me kriterin tjetër, shkallën e fajit nga tërësia e të gjithë veprimeve të të pandehurit, Gjykata thekson se ato janë kryer në formën e dashjes direkte, formë e cila përbën edhe shkallën më të lartë të fajit. Kjo për faktin, pasi i pandehuri, ka qenë në gjendje të kuptonte karakterin e kundërligjshëm të veprimit të tij, dhe përsëri ka organizuar një grumbullim apo manifestim në kundërshtim me ligjin, pa marrë më parë leje te organet kompetente.

19. Në caktimin e masës së dënimit kundër autorit të vepërës penale penale konkrete, gjykata mban parasysh, ndër të tjera, rrethanat rënduese dhe lehtësuese, të cilat janë faktorë të ndryshëm objektivë dhe subjektivë që tregojnë për një shkallë rrezikshmërie më të ulët ose më të lartë të veprës dhe të fajtorit. Gjykata, në çështjen objekt gjykimi mban parasysh faktin që ndaj të

pandehurit Arvit Bushati nuk konstatohet asnjë rrethanë rënduese nga ato të parashikuara nga neni 50 të Kodit Penal dhe asnjë rrethanë lehtësuese e parashikuar nga neni 48 i Kodit Penal.

20. Sa më sipër u arsyetua, duke analizuar në kompleksitet të gjitha rrethanat e përmendura më sipër Gjykata çmon se, i pandehuri nuk paraqet rrezikshmëri shoqërore të tillë, e cila e bën të nevojshme dhe të domosdoshme që gjykata të japë një masë dënimi të rëndë ndaj tij. Për rrjedhojë, mbështetur në nenet 47-50 të Kodit Penal dhe neni 34 i K.Penal që parashikon kufijtë e dënimit me gjobë për kundravajtjet penale, Gjykata çmon se, i pandehuri Arvit Bushati duhet të dënohet me 90.000 (nëntëdhjetë mijë) lekë gjobë, për kryerjen e veprës penale të "Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime dhe manifestime të paligjshme", parashikuar nga neni 262/1 i Kodit Penal. Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale të pandehurit i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit dhe përfundimisht i pandehuri Arvit Bushati dënohet me 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë gjobë, e cila duhet të paguhet në një afat brenda 6 (gjashtë) muaj nga momenti që vendimi të marrë formë të prerë. Gjykata çmon se, dënimi i mësipërm është në përputhje me rrezikshmërinë e veprës penale, për të cilën ligji parashikon një dënim me gjobë ose deri në një vit burgim, si dhe rrezikshmërinë e autorit në rastin konkret.

#### PËR KËTO ARSYE:

Gjykata, bazuar në nenet 378 - 390, 403, 405, 406 të Kodit të Procedurës Penale;

#### VENDOSI:

1. Deklarimin fajtor të të pandehurit Arvit Ridvan Bushati për kryerjen e veprës penale të "Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime dhe manifestime të paligjshme", parashikuar nga neni 262/1 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 90.000 (nëntëdhjetë mijë) lekë gjobë.
2. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit Arvit Bushati i ulet 1/3 e dënimit duke u dënuar përfundimisht me 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë gjobë, e cila duhet të paguhet brenda një afati prej 6 (gjashtë) muaj nga momenti kur vendimi të marrë formë të prerë.
3. Shpenzimet procedurale të parapaguara nga shteti në fazën e hetimeve paraprake, në shumën 2.000 (dymijë) lekë, i ngarkohen të pandehurit.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Shkodër, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmeja e shpalljes të këtij vendimi. Për të pandehurin, ky afat fillon nga e nesërmeja e njohimit të vendimit.

U shpall në Shkodër, sot më datë 26.03.2018

Sekretare  
Mirela Vuksani



Gjyqtare  
Luveda Dardha

